

PLANI I BIZNESIT PËR AKS

AGJENCIA KOSOVARE E STANDARDIZIMIT

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në strukturën e përgjithshme të planit të biznesit, përmbledhja ekzekutive vjen pas faqes së titulli. Përmbledhja i tregon lexuesit se çfarë dëshironi ju. Kjo është shumë e rëndësishme. Tepër shpesh, ajo që dëshiron pronari i biznesit fshihet në faqen e tetë. Në përmbledhje cekeni qartë se çfarë jeni duke kërkuar.

2.MISIONI

Misioni i AKS-së është të miratojë standarde, t'i harmonizojë ato me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe, si rrjedhojë, të nxisë fuqishëm zhvillimin ekonomik duke krijuar bazës për konkurrueshmëri në rajon dhe më tej.

3.PËRSHKRIMI I BIZNESIT

Organi kombëtar i standardizimit në Kosovë, ASK, e themeluar më 2005, përfaqëson të gjitha interesat në standardizim, si në nivelin e brendshëm, ashtu edhe në raport me organizata kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare. Ajo funksionon sipas Ligjit nr. 03/L-144 për Standardizimin, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Në përputhje me praktikën e mira në organet e zhvilluara kombëtare të standardizimit, ajo drejtohet nga organi i përbërë prej 9 përfaqësuesish të akterëve, Këshilli i Standardeve Profesionale (KSP). Udhëzimi Administrativ 02/2012 rregullon funksionimin e KSP-së.

Në nivel të brendshëm, AKS-ja është përgjegjëse për elaborimin e standardeve kombëtare për Kosovën me shenjën SK dhe sistem të veçantë të numërimit. Për këtë qëllim ajo ka formuar deri më tani 18 komitete teknike (KT) për të mbuluar dhe për t'u shërbyer sektorëve teknikë që janë identifikuar si të rëndësishëm deri më tani

- për ekonominë kombëtare,
- për interesat rregullativë të qeverisë dhe institucioneve të saj të veçanta,
- për sigurinë e qytetarëve,
- për të mbrojtur konsumatorët dhe mjedisin.

Me këto 18 KT struktura aktuale teknike pasqyrohet mirë.

Puna në KT bëhet nga rreth 150 ekspertë që vijnë nga jashtë në baza vullnetare dhe me honorar. Stimuli i vetëm për bërjen e kësaj pune është dreka në pauzën e mbledhjeve dhe zbritja prej

50% e çmimit të shitjes së standardeve për institucionet nga vijnë ekspertët. Megjithatë, kjo e fundit nuk është fort e rëndësishme, pasi që çmimet e shitjes edhe ashtu janë të ulët.

Portali i Sistemit të Informimit për Menaxhimin e Standardeve (SIMS) i shërben personelit të AKS-së që është përgjegjës për organizimin e KT-ve dhe procedimin e standardeve për miratim përmes këtij sistemi.

Të gjitha të dhënat e futura në SIMS do të dalin në portalin në internet www.aks.rks-gov.net. Kjo faqe u dedikohet konsumatorëve, bizneseve dhe më gjerë. Ueb faqja e AKS-së është mjet i rëndësishëm për transparencë në punën e standardizimit.

Anëtarët e KT-ve janë të privilegjuar, pasi që ata mund të bashkëpunojnë me AKS-në dhe sekretariatet e KT-ve përmes SIMS-it.

Në rrethanat aktuale, elaborimi i standardeve është përqendruar ekskluzivisht në miratimin e standardeve evropiane (EN), mbi të gjitha për dy arsye.

- Kosova si vend goxha i vogël me bazë të vogël industriale, me përjashtim të disa aktiviteteve të mihjes, këshillohet të mos zhvillojë standarde në fushat ku veç ekzistojnë standarde të përshtatshme në vende të tjera apo në nivele të tjera. Kështu, vetëm një pjesë e standardeve shumë të veçanta mbetet si tema për t'u trajtuar vetë.
- Për anëtarësim në CEN (Comité Européen de Normalisation) dhe CENELEC (Comité Européen de Normalisation Electrotechnique), një prej parakushteve është që të jenë miratuar të paktën 80% e gjithsej EN-ve ekzistues.

Për fat të keq, edhe nëse e përmbush këtë një ditë, AKS-ja ende nuk mund të bëhet anëtare e këtyre organizatave evropiane të standardizimit, pasi që një parakusht tjetër është që të jetë anëtare e ISO-së dhe IEC-së, përkatësisht (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit dhe Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik). Parakusht për anëtarësim në këto të fundit është që vendi amë i organit kombëtar të standardizimit të jetë anëtar në Kombet e Bashkuara (KB). Prandaj, përpjekjet e AKS-në bazohen në shpresën që këto kushte do të plotësohen së shpejti dhe krejt çfarë mund të bëjë ajo është që të përgatitet për këtë rast.

Shkalla e miratimit më 2014 ishte rreth 900 EN. Me këtë gjithsej numri i miratimeve u afrua në 8.000; në raport me mbi 19 000 EN, ky numër është më pak se 50% karshi 80% që duhet arritur. Kur të arrijë në 10 000 standarde, AKS-ja planifikon ta zvogëlojë shpejtësinë e miratimeve të mëtejme për të ruajtur kapacitetet për interesa të tjerë të ardhshëm, që janë përshkruar më poshtë në këtë plan biznesi. Përzgjedhja e standardeve që duhet miratuar bëhet nga vetë AKS-ja. Kur e bën këtë, ajo duhet gjithmonë të mendohet me kujdes se cilat kritere të zbatohet për të pasqyruar nevojat e vërteta të vendit. Si shembull, standardet në fushën detare sigurisht që nuk zbatohen në Kosovë si vend pa dalje në det që është.

Një përparësi për AKS-në është fqinjësia me Shqipërinë dhe gjuha e përbashkët shqipe. Kjo i jep AKS-në mundësinë të marrë standarde evropiane që veç janë miratuar nga DPS, organi kombëtar i standardizimit në Shqipëri, në gjuhën amtare. Një dobësi e kësaj procedure është që zakonisht merr shumë kohë marrja e standardeve të kërkuara. Ky shërbim nga DPS-ja i kushton AKS-së rreth 30.000 € në vit. Në raste urgjente mund të shqyrtohen burime të tjera për marrjen e EN-ve, edhe nëse jo në gjuhën amtare.

AKS-ja po ashtu bën shitjen e standardeve, megjithëse shkalla e shitjes deri më tani është jashtëzakonisht e ulët. Rreth 200 standarde u shitën në vitin e kaluar. Një hetim në radhët e akterëve të mundshëm mund të nxjerrë në pah arsyet për këtë interesim të kufizuar.

E gjithë puna kryhet me 7 punonjës për momentin, prej të cilëve një drejtor që udhëheq institucionin me një sekretar, një drejtor tjetër për promovimin dhe integrimin e standardeve, nën drejtimin e të cilit funksionojnë katër sektorë, dy për standardizim dhe dy për promovim dhe integrim. Këta punojnë në dy zyra me qira në kuadër të Agjencisë Kombëtare të Metrologjisë (AKM).

Prezantimi më i hollësishëm i AKS-së mund të merret nga broshura “AKS 10” e publikuar me rastin e 10 vjetorit të saj, duke përfshirë edhe listën e plotë të 18 komiteteve teknike ekzistuese.

4.ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)

AKS-ja nuk mund të krahasohet me organet kombëtare të standardizimit, të zhvilluar dhe me reputacion, të tillë si ASTM në Shtetet e Bashkuara, DIN në Gjermani, BSI në Britani të Madhe ose të tjerë. Ajo duhet të krahasohet me organe kombëtare të standardizimit që ekzitojnë në rrethana ngjashëm të pafavorshme. Në bazë të kësaj, AKS-ja mund të analizohet si më poshtë:

Fuqitë

- o institucion i themeluar për mbi 10 vjet,
- o monopol i punës së standardizimit për momentin
- o zotimi ndaj parimeve të standardeve vullnetar edhe konsensusit,
- o grupi i besueshëm i ekspertëve,
- o struktura ekzistuese e KT-ve (18 deri më tani),
- o gati 8.000 EN të miratuar si SK (standarde kosovare),
- o menaxhmenti dhe personeli i angazhuar,
- o sistemi i shitjes së standardeve,
- o katalogu ekzistues i standardeve ekzistuese kombëtare SK,
- o mbështetja nga BE-ja përmes disa projekteve të asistencës,
- o Punonjësit e AKS-së janë shërbyes civilë
- o Stabiliteti politik përmes KFOR-it,
- o Fqinjësia me DPS-në në Shqipëri si anëtare e CEN-it dhe ISO-së (gjuha e njëjtë përparësi për bashkëpunim të ngushtë).

Dobësitë

- o vetëm 7 punonjës në gjithë AKS-në,
- o nuk ka zyra apo ndërtesë të veten,
- o nuk është pjesë e punëve të standardizimit në nivel ndërkombëtar dhe evropian,

- o nuk ka të ardhura vetanake financiare apo mbështetje (shifra e shitjeve të standardeve 200 në vit),
- o varësia në një ministri, prandaj nuk mund të mbahen të ardhurat vetanake,
- o çmimet e ulëta të standardeve,
- o vëmendje e pamjaftueshme për AKS-në dhe standardizimin në tërësi në vend,
- o vetëdijesim i ulët rreth standardizimit të NMV-të,
- o niveli i ulët ekonomik bën që standardet të jenë të panevojshëm
- o Mbështetja apo stimujt e pakët për ekspertët vullnetarë që punojnë në komitetet teknike,
- o mungesa e strategjisë së marrëdhënieve me publikun,
- o sistemi i konsultimit rreth standardizimit nuk është i zhvilluar mirë.

Mundësitë

- o anëtarësimi në CEN/CENELEC dhe ISO/IEC pas pranimit të Kosovës si shtet anëtar i OKB-së,
- o Pas anëtarësimit në ETSI (Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit, pas ndryshimit të ligjit aktual të standardizimit
- o rritja e kontakteve ndërkombëtare në zhvillimin e pozicionimit të brendshëm,
- o rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e standardizimit në radhët e akterëve të tregut,
- o rritja e mundësive të shitjes përmes zhvillimit dhe rritjes ekonomike,
- o ndryshimi i ligjit ekzistues të standardizimit për të mundësuar certifikimin dhe llojet e tjera të biznesit, si dhe përr të mbajtur të ardhurat,
- o zhvillimi i shërbimeve shtesë si kurset e trajnimit,
- o përdorimi i mediave dhe mjeteve elektronike për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja,
- o marrëveshjet e bashkëpunimit me organet e tjera kombëtare të standardizimit.

Kërcënimet

- o konkurrenca në rritje nga forumet dhe konsorciumet që hartojnë specifikacione të ngjashme me standardet,
- o pjesëmarrja e ekspertëve nuk është në hap me zhvillimet,
- o kufizimet buxhetore do të vazhdojnë më tej për shkak të shkallës së ulët të shitjes dhe kufizimeve të të ardhurave nga rregullat publike të buxhetimit,
- o përkthimi, në rastin e vonesave në marrjen e verzioneve në gjuhën shqipe të standardeve evropiane të miratuara si SSH nga DPS-ja
- o rreziku i humbjes së buxhetit nga vendimet qeveritare për zvogëlimin e buxhetit
- o shpërndarja ose kopjimi ilegal i standardeve.

5. TRATEGJITË E TREGUT

Strategjitë e tregut janë rezultat i analizës së kujdesshme të tregut. Analiza e tregut e detyron ndërmarrësin të njihet me të gjitha aspektet e tregut ashtu që të mund të përcaktohet tregu i synuar dhe kompania të mund të pozicionohet për të mbledhur përqindjen e saj të shitjeve.

Pas 10 vitesh pune të suksesshme, hapat e ardhshëm duhet të ndërmerren për të arritur cakun e ri në periudhë 5 vjeçare.

Me ndihmën e ligjit të ndryshuar të standardizimit, që do të mundësojë shtrirjen e biznesit nga standardizimi i thjeshtë te certifikimi, trajnimi, informimi dhe konsultimi, AKS-ja duhet të zhvillohet në një organ qendror për të gjitha llojet e informimit dhe konsultimit teknik, ndërsa standardizimi do të luajë vetëm një rol. Në të ardhmen, dokumentimi, informimi, shitjet, kurset e trajnimit, konsultimi, certifikimi dhe ndoshta shërbimi i konsorciumeve në punën e tyre me specifikacionet do të paraqesë pasqyron e përgjithshme të këtij organi qendror. Jo vetëm që do të përdoren të gjitha këto lloje shërbimesh nga i gjithë spektri i akterëve, por AKS-ja do të njihet si pikë kontaktuese.

Përvojat e mira mund të shërbejnë si shembuj, si Ndhma Teknike për Eksportuesit (THE) në Britaninë e Madhe, Qendra Informativ Gjermane për Rregullat Teknike në Gjermani, AENOR në Spanjë, që sot merret më tepër me certifikim sesa standardizim, organi kombëtar i standardizimit në Uruguay (UNIT), që fiton pjesën më të madhe të parave të tij me kurse trajnimi, edhe jashtë fushës së standardizimit, e shumë të tjera. zgjerimi në këtë spektër të plotë produktesh dhe shërbimesh po ashtu mund t'ia heqë standardizimit namin e të qenit diçka e thatë dhe e mërzitshme, për mbushjen e dosjeve apo rafteve, ku AKS-ja do të tregojë edhe për çfarë janë standardet dhe si përdoren.

Sipas Bankës Botërore, zhvillimi ekonomik i Kosovës pritet në sektorët e energjisë dhe minierave. Rritje mund të pritet edhe në bujqësi. Ekspertët e BE-së rekomandojnë një reformë strukturore të këtij sektori me rritje të konsiderueshme të rendimentit dhe ngritjen e industrisë lokale të ushqimit, veshjeve, mobileve dhe ndërtimit të makinave të thjeshta. Të gjithë këta sektorë mbulohen nga standarde që ndërlidhen me përputhshmërinë, cilësinë dhe procedurat e testimit. Këtu mund të shihet mundësia e AKS-së pasi të marrë hov zhvillimi i këtyre sektorëve. 18 KT-të ekzistues të AKS-së i mbulojnë të gjithë këta sektorë të zhvillimit dhe pritet të përfitojnë nga këto pritje.

Kërcënimet kryesore kanë të bëjnë me infrastrukturën e keqe, mungesën e profesionistëve të aftë në fushat përkatëse, situata e përgjithshme jo stabilë politike, si dhe mungesa e reformave ekonomike në aspektin e vetë-qeverisjes lokale.

Për të shqyrtuar në hollësi pritet dhe nevojat e tregut, është bërë një studim i akterëve ekzistues dhe potencialë, i cili përbën bazën e kësaj strategjie dhe të planit të mëposhtëm të dizajnit dhe zhvillimit. Studimi u krye në dy pjesë. Në pjesën e parë, 27 pjesëmarrësve në një ngjarje iu kërkua të plotësonin pyetësorë, në praninë e dy ekspertëve nga projekti i BE-së, të cilët ishin aty për pyetje apo komente. Në pjesën e dytë, u vizituan personat ose institucionet që u konsideruan me interes të veçantë për këtë studim.

6.PLANI I DIZAJNIT DHE ZHVILIMIT

Qëllimi i pjesës së planit të dizajnit dhe zhvillimit është t'u ofrojë investitorëve një përshkrim të dizajnit të produktit, të paraqesë zhvillimin e tij në kontekstin e prodhimit, marketingut dhe

vetë kompanisë, si dhe të krijojë një buxhet të zhvillimit që do t'i mundësojë kompanisë të arrijë synimet e saj.

Për momentin, AKS-ja është thjesht një institucion që prodhon standarde, me përpjekje marketingu dhe realizueshmëri të shitjeve të pavërejtura. Për ta shndërruar AKS-në në një pikë kontaktuese qendrore dhe të respektuar për informata dhe shërbime teknike, asaj duhet t'i jepet fushëveprim më i gjerë duke përfshirë

- të jetë qendër informative për të gjitha dokumentet teknike – vullnetare ose të detyrueshme (preferohet të përfshijë pikën e kërimit TBT)
- shërbimet e certifikimit për të marrë shenjë KK
- kurse trajnimi mbi standardizimin dhe përdorimi i standardeve të veçanta
- përgatitja për shërbimet për forumet apo konsorciumet nikoqire për zhvillimin e llojeve të tjera të specifikacioneve, jo standardeve.

7.SYNIMET STRATEGJIKE

Synimet në vijim konsiderohen të jenë në harmoni të plotë me deklaratën e misionit të AKS-së:

1. AKS-ja të jetë organizatë e menaxhuar mirë dhe që funksionon në mënyrë efikase
2. AKS-ja të jetë në përputhje me nevojat e tregut dhe të kënaqë konsumatorët përmes ofrimit të produkteve (standartet dhe rezultatet e tjera) dhe shërbimeve (p.sh., trajnimi, konsultimi) të cilësisë së lartë në kohë optimale
3. Të kontribuojë në lehtësimin e tregtisë brenda dhe përtej kufijve
- 3.1. duke rritur konkurrueshmërinë e prodhuesve kosovarë,
- 3.2. duke lehtësuar qasjen në produkte dhe shërbime të cilësisë së kërkuar për konsumatorët kosovarë,
- 3.3. ndër të tjera përmes sistemit të certifikimit,
4. Të mbështesë politikën teknike të qeverisë dhe administratës
5. Të sigurojë koherencën dhe eficiencën e sistemit kombëtar të standardizimit të lidhur me ato evropiane dhe ndërkombëtare,
6. Të promovojë përparësitë e pjesëmarrjes në standardizim dhe përdorimin e standardeve.

8.STRATEGJIA – REALIZIMI I SYNIMEVE STRATEGJIKE – SYNIMET E HOLLËSISHME (CAQET)

Synimi strategjik nr. 1:

Organizatë e menaxhuar mirë dhe që funksionon në mënyrë efikase

- racionalizimi i strukturës organizative duke pasur parasysh që për momentin ka “shumë komandantë dhe pak ushtarë”

- o ekzistenca e dy drejtorëve për një personel prej 7 punonjësish është e pakuptimtë
- o me zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve të rritet numri i punonjësve dhe kualifikimet e tyre (me rëndësi financiare)
- o tërheqja dhe mbajtja e ekspertëve të lartë në KT
- o krijimi i sistemit të qartë dhe miqësor të rregullave dhe procedurave,
- o zhvillimi i doracakut të cilësisë sipas ISO 9001
- o mjetet optimale të TIK-ut, ku është e zbatueshme
- o integrimi i sistemeve të TI-së, nëse nuk ekzistojnë
- o kontakti i përhershëm i afërt me akterët

Synimi strategjik nr. 2:

Të jetë në përputhje me nevojat e tregut dhe të kënaqë kërkesat e akterëve të tregut

- o përzgjedhja e EN-ve që do të miratohen të bëhet nga KT-të apo palët e jashtme, jo nga sekretariati
- o zhvillimi dhe marketingu aktiv i ofertës tregtare,
- o promovimi aktiv i shenjës së konformitetit (KK) me Standardet e Kosovës (certifikimi) (vitet e ardhshme)
- o përgatitja për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të konformitetit,
- o partneriteti me vendet fqinje, përtej Shqipërisë
- o zhvillimi i standardeve vetanake kosovare ku konsiderohet e rëndësishme
- o proceset plotësisht elektronike,
- o marrja me punë të reja vetëm me kërkesë të akterëve
- o përdorimi i Këshillit të Standardizimit si organ që shpreh kërkesat e akterëve të standardizimit.

Synimi strategjik nr. 3:

Kontribuimi në lehtësimin e tregtisë

- o certifikimi vullnetar për t'u ofruar prodhuesve lokalë një mjet për konstatimin e cilësisë së produkteve të tyre (shenja KK)
- o për këtë të krijohet infrastruktura e nevojshme në AKS
- o objektet e testimi për këtë mund të përdoren nga jashtë
- o vetëm puna administrative të mbetet në AKS
- o përgatitja për konsultim në fushën e certifikimit, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar
- o ndihma përmes konsultimit për marrjen e shenjës CE për prodhuesit apo eksportuesit kosovarë
- o bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e konsumatorëve
- o promovimi te konsumatorët që t'i shikojnë certifikatat apo shenjimet para se të marrin vendimin e blerjes
- o zhvillimi i shërbimit të sistemit të konsultimit/këshillimit
- o krijimi i diçkaje të ngjashme me ndihmën teknike për eksportuesit
- o me të gjitha të mësipërmet të krijohet pika kontaktuese për informata teknike, duke përfshirë pikën TBT

Synimi strategjik nr. 4:

Mbështetja e politikave teknike të qeverisë dhe administratës

- o bashkëpunimi me administratën qeveritare me synim të përfaqësimit të Kosovës në CEN/CENELEC, ETSI dhe UN-ECE në fushën e politikave teknike duke përfshirë krijimin e rrjetit të ekspertëve nga njësitë/zyrat e administratës,
- o njoftimi i qeverisë me parimin e referimit ndaj standardeve në rregullore (si parimi i Qasjes së Re)
- o ofrimi për trajtimin me prioritet të aplikacioneve të qeverisë dhe administratave të saj për zhvillimin apo miratimin e standardeve, nëse financohen siç duhet
- o tërheqja e përfaqësuesve të ministrive dhe administratave për të marrë pjesë aktivisht si ekspertë në KT

Synimi strategjik nr. 5:

Koherenca dhe efienca e sistemit kombëtar të standardizimit të lidhur me ato evropiane dhe ndërkombëtare

- o përafrimi me CEN dhe CENELEC si hap i parë i anëtarësimit,
- o në rast të kërkesave të tregut, miratimi i standardeve ndërkombëtare, kur nuk ekzistojnë EN-të e përshtatshëm
- o zbatimi dhe shpërndarja e plotë e rregullave evropiane të standardizimit (zhvillimi i testit të njohurive në lidhje me rregullat)
- o bashkëpunimi i duhur dhe i përpiktë në nivel kombëtar për miratimin e standardeve evropiane (rregulli i 6 muajve) dhe ndërkombëtare
- o lidhja ndërmjet sistemit të TI-së (bazës së të dhënave) dhe atyre evropiane (CEN dhe CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO/IEC) (interesi automatik për importimin e të dhënave programore të CEN/CLC dhe ISO/IEC (relevante për Kosovën?))

Synimi strategjik nr. 6:

Përparësitë e pjesëmarrjes në standardizim dhe përdorimi i standardeve

- o ftesa që aplikantët për njësi të reja të punës të ofrojnë draftin e parë punues
- o reklamimi i përparësive të pjesëmarrjes aktive përmes
- o informimit të hershëm mbi trendët dhe zhvillimet
- o takimit me konkurrentët apo konsumatorët potencialë
- o ndikimit të përmbajtjes së standardeve që zhvillohen
- o realizimi i fushatave të promovimit duke përfshirë ato ku akterët janë të gatshëm të marrin pjesë financiarisht
- o zhvillimi i sistemit të jashtëm të trajnimit, konsultimit, informimit dhe bashkëpunimit me universitetet, p.sh. lansimi i trajnimeve të anëtarëve të përzgjedhur të KT-ve të industrisë (“shumëzuesit “e mundshëm) lidhur me përparësitë e pjesëmarrjes aktive në

- o vendosjen e standardeve
- o promovimi i aktiviteteve dhe produkteve të standardizimit të AKS-së në internet (jo vetëm në uebfaqen e AKS-së) në portale dhe uebfaqe

9.FAKTORËT FINANCIARË

Buxheti vjetor i AKS-së është 96.047,57 €, nga të cilat 49.847,46 € për paga të punëtorëve dhe 44.870,29 € për shërbime

AKS-ja nuk paguan qiranë dhe shërbimet e furnizimit, pasi që MTI-ja (qeveria) kujdeset për këtë.